



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:108821
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05725123

AA.nr.659/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, V.H, Komuna e Lipjanit, të cilin me autorizim e përfaqëson, Herolind Kryeziu, avokat nga Lipjani, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, përkitazi me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1469/2020, të datës;19.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1469/2020, i datës;19.06.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1469/2020, të datës;19.06.2023, është vendosur, “*I. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit, V.H nga Komuna e Lipjanit, Anulohet aktvendimi i të paditurës MPMS/DPA-së, 6023733 i datës 28.12.2020, dhe vendimi i organit administrativ në shkallë të parë dt. 24.01.2018 ndërsa i njihet e drejta në Pension të Personave me Aftësi të Kufizuar prej datës së nxjerrjes së ekspertizës datë 02.02.2023 e deri me datën 02.02.2026 për tre (3) vite në vlerën e pensionit prej 100 euro (njëqindën euro) për çdo muaj. II. Obligohet e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, që paditësit t’ia kompensojë në mënyrë retroaktive pagesën në emër të pensionit për personat me aftësi të kufizuar(PPAK) për periudhën kohore nga data e ndërprerjes së pensionit me aftësi të kufizuar datë 24.01.2018 në vlerën e caktuar prej 75 euro (shtatëdhjetë) e pas kësaj date të vazhdohet me pagesën prej 100 euro (njëqindën euro) për çdo muaj nga dt.12.01.2022 deri në nxjerrjen e ekspertizës datë 02.02.2023, krejt këto në afat prej 15 ditësh, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë. III. Udhëzohet paditësi që pas tri (3) viteve nga momenti i njohjes së kësaj të drejte, të paraqesë*

kërkesë për rivlerësim mjekësorë tek e paditura, për të vazhduar njohjen e kësaj të drejte. IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e nulura.”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, përmes Avokaturës Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e të paditurës, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi A.nr.1469/2020, të datës;19.06.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të anulohet, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me të cilën i ka propozuar Gjykatës që ankesën e të paditurës ta refuzon dhe ta vërteton aktgjykimin e goditur si të drejtë dhe të ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të paditurës dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë;04.09.2020, kundër vendimeve të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale në Prishtinë, sepse konsideron se vendimet kundërshtuar me padi janë të pa bazuar dhe jo i ligjshëm, për arsye se nuk është vlerësuar drejtë gjendja faktike nga ana e organeve administrative, si dhe është zbatuar gabimisht edhe ligji material, me propozim që të njëjtit të anulohen në tërësi, si dhe t’i njihet e drejta në pension për personat me paaftësi të kufizuar.

Gjykata e shkallës së parë pasi ka vlerësuar vendimet e kundërshtuara dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, me arsyetim se “Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimeve të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar. Nga vendimet kontestuar del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 47 këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 48 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Për të sqaruar më tutje gjendjen faktike, gjykata me aktvendimin ka caktuar nxjerrjen provës me ekspertizë, dhe kryerjen e të njëjtës i’ a ka besuar Qendrës Klinike Universitare të

Kosovës në Prishtinë, e cila me vendimin e datës 17.01.2023 për të punuar ekspertizën mjekësorë si ekspert mjekësorë ka caktuar: Dr.F.H -Fiziatre, Dr.F.A Neurol dhe Dr.M.K-Psikiatër. Kjo gjykatë pas administrimit të gjitha provave, falë besimin ekspertizës mjekësorë hartuar nga ekspertet prezent në seancën e shqyrtimit kryesor, te njëjtit deklaruan se qëndrojnë në tërësi prapa ekspertizës së dhënë në gjykatë duke theksuar se si në ekspertizë komisioni ka konstatuar se gjendja e pacientit – paditësit është e përhershme pa shpresa për përmasimi andaj dhe aftësia e punës është e reduktuar dhe pacienti është e paaftë për punë. Po ashtu, kjo gjykatë ka vlerësuar si provë dhe vlerësimin e Komisionit mjekësor të paditurës për faktin se pikërisht këto komisione mjekësore i kanë njohur njëherë këtë pension paditësit për periudhën kohore disa vite duke theksuar se është person me aftësi të kufizuara të përhershme dhe pastaj i ndërprerjen këtë të drejtë në rivlerësim me dt.28.12.2020 me arsyetimin se në bazë të vlerësimit të komisionit mjekësor ka ardhur në përfundim se tek e njëjta aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston. Mirëpo nga shkresat e lëndës shihet dhe vërtetohet se gjendja e tij shëndetësore nuk ka ndryshuar dhe këtë fakt e vërtetoj dhe ekspertiza e QKUK-së, në procedurën gjyqësore, për të gjitha këto arsye kjo gjykatë nuk mundi të falë besimin mendimit dhe konstatimit të komisionit mjekësor të paditurës si provë e vetme e që vërteton se paaftësia e përhershme e kufizuar të paditësi nuk ekziston dhe për këto arsye ka vlerësuar dhe vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Prandaj për faktin se paditësi ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për njohjen e kësaj të drejte nga gjykata kjo e fundit kërkesëpadinë tij e aprovoj si të bazuar dhe si rrjedhojë e detyroj të paditurën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi meqë vlerësoj se sa i përket mendimeve dhe vlerësimit të eksperteve, ekspertiza është e çart, nuk ka kontradiktoritet në vete si dhe e paditura nuk e ka kontestuar, nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re madje e paditura nuk i është përgjigjur as ftesave për seancën e shqyrtimit kryesor. Për të gjitha këto arsye kjo gjykatë me qëllim të respektimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, respektivisht në respektim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për një proces të rregullt brenda afateve të arsyeshme, nga vlerësimi i përgjithshëm ka krijuar bindje se ekspertiza e nxjerrë nga QKUK, është provë e besueshme e paanshme për të vendosur çështjen. Po ashtu sipas Konventës për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Protokollin Opsional Në York, 2006 neni 1. parashihet se "Qëllimi i kësaj Konvente është të nxis, mbroj dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe lirit themelore të njeriut si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e njeriut". Fakti se Republika e Kosovës në Kushtetutën e saj neni 22, i saj ka marr përgjegjësi për zbatimin e Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare që kanë për qëllim respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të gjithë personave pa dallime, në këtë kontest dhe e paditura duke pasur parasysh se kjo kategori e personave ka nevoja të veçantë është në mandatin e saj të zhvilloj politika dhe të krijoj mundësi të barabarta për këta persona që të gëzojnë shërbime për nevojat e tyre dhe që shkojnë në mbrojtje të dinjitetit të kësaj kategori ashtu që të jenë pjesë aktive dhe e dobishme e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë. Nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata vërtetoj se paditësi e lart cekur është person me aftësi të kufizuara dhe në përputhje të nenit të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht neni 9, paragrafët 1 dhe 5 të të njëjtit, ku përcaktohet se "Pensioni i paaftësisë të përhershme do t'iu ofrojë mbështetje financiare personave të përzgjedhur në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë ligj, sipas mjeteve të ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Republikës së Kosovës". Një person do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, nëse: ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore; Komisioni Mjekësor vlerëson se ekziston pa aftësia e përhershme e punës të parashtruesi i kërkesës; Komisioni Mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje për periudhën prej një (1), tre (3) apo pesë (5) vitesh;. Pas skadimit të afateve të përcaktuara në nen paragrafin 5.3 të këtij paragrafi personi i nënshtrohet procedurës së rivlerësimit mjekësor." Kjo gjykatë vlerësoj dhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi se vendimi

është nxjerrë bazuar në dispozita e ligjit mirëpo të njëjtat pasi u vlersuan i refuzoj nga fakti se nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor është vërtetuar se paditësi i plotëson kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës së kërkuar.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron, ngase e paditura të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPK-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, LKA-së dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se e paditura në ankesë vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi jo i drejtë e gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, me ekspertizën e nxjerrë nga Gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditësit të datës;17.01.2023, e cila është përgatitur nga mjekë specialist të SHSKUK-së në Prishtinë, Dr. F.H-Fiziatre, Dr. F.A-Neurolog, dhe Dr. M.K-Psikiatër, të cilët gjatë sqarimeve të dhëna në seancë, të njëjtit kanë deklaruar *“Se qëndrojnë në tërësi prapa ekspertizës së dhënë në gjykatë duke theksuar se si në ekspertizë komisioni ka konstatuar se gjendja e pacientit–paditësit është e përhershme pa shpresa për përmisim andaj dhe aftësia e punës është e reduktuar dhe pacienti është e paaftë për punë.”* Ndërsa këtë ekspertizë e ka kundërshtuar e paditura, por nuk i ka propozuar gjykatës ndonjë ekspertizë, për ti kundërshtuar përfundimet e nxjerra nga ekspertet mjekësor. Prandaj, pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i apelit vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe në pajtim me dispozitat ligjore.

Kurse sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata e shkallës së parë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, kolegji i apelit nuk i aprovoj, për faktin se ekspertiza mjekësore është e qartë dhe nuk ka kontradiktë në vete, si dhe e paditura nuk ka dhënë ndonjë propozim për ndonjë ekspertizë të re, e cila eventualisht do ta vërtetonte të kundërtën nga ajo që është dhënë në ekspertizë. Prandaj, të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit dhe se e njëjta drejtë ka zbatuar dispozitat Ligjit Nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht nenin 9 të tij, kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të kontestuar.

Nga e gjithë kjo që u theksua më lartë dhe mbi këtë gjendje, faktike kolegji i apelit konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në

dëm të paditurës, dhe se thëniet e ankesës ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë, ngase aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, në këtë kuptim ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.659/2023, datë;20.05.2024

Kryetar i kolegjit
Hajriz Hoti